



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së, Jeton Qela, U.d Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 07.02.2024 020-117
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gafurr Sllamniku, Zyrtar i lartë për Monitorimin e Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 12/24 për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës për Bashkëpunim ndër komunal
I miratuar më datë: 25.01.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.02.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

MAPL, konstaton se **Vendim Nr. 12/24** për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës për Bashkëpunim ndër komunal, nxjerrë nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 25.01.2024, dhe është bazuar në është bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Ferit Idrizi, gradonačelnik opštine Vučitrn Melihate Basholli-Latifi, predsedavajuća Skupštine opštine Vučitrn	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Jeton Qela, zamenik generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Murtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i i monitorisanje opština, MALS	Dana, 07.02.2024 020-117
Odgovorni službenici: 1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene: 2. Službenik-ca za izradu pravne procene	Xhevat Tafa, Rukovodilac Odseka za monitorisanje opština Gafurr Sllamniku, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Zahtev za razmatranje akta Skupštine opštine Vučitrn	
Vrsta akata:	Odluke	

Poštovani gradonačelnice,

Poštovana predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluku br. 12/24 o odobrenju Inicijative gradonačelnika za međuopštinska saradnja
Usvojena dana, 25.01.2024
Preložena na razmatranje u MALS-u dana 06.01.2024.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.


Obrazloženje

MALS pronalazi tu odluku br. 12/24 o odobrenju Inicijative gradonačelnika za međuopštinska saradnja, koju je Donela Skupština opštine na sednici održanoj 25.01.2024. godine, a zasniva se na članu 12 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi i članu 7 Zakona br. 04/L-010 o međukomunama.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za bilo koje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKANOSOVA
KOMUNA E VUSHTRRISË OPŠTINA VUŠTRIC
01 Nr. / Nr. 47/24
Nr. i sq. / Broj. -1-
Data / Datum 01.02.2024
VUSHTRRI - VUŠTRIC



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008) nenin 7 të Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal Nr. 04/L-010 (Gazeta Zyrtare e Republikës Nr. 7/10 Gusht 2011), nenin 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 25 janar 2024 të vazhduar me 01 shkurt 2024 merr këtë:

V E N D I M PËR MIRATIMIN E NISMËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministritive Localne Samouprave / Administratione
Ministry of Local Government Administration
Date: 06.02.2024
Broj. organizator: 01 Broj. Lashës: 020-117 Viza:

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë 02Nr. 47/24 datë 23.01.2024 për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunave: Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Prishtinë dhe Podujevë, për realizim të projekteve me interes të përbashkët.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, miratohet propozim vendimi për financim të përbashkët të studimit të fizibilitetit si dhe hartimit të projektit detaj/zbatues për ndërtimin e rrugës: Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të filloj konsultimet me Kryetarët e Komunave nga pika 1 (një) e këtij vendimi për të përgatitur Draftin e Marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal për financim të përbashkët të studimit të fizibilitetit dhe hartimit të projektit detaj.
4. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
5. Vendim iu dërgohet : MAPL-së dhe Kryetarëve të Komunave: Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq dhe Podujevë.


Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

DRAFT



Kryeqyteti
Prishtinë



Komuna
Mitrovicë e Jugut



Komuna
Vushtrri



Komuna
Podujevë



Komuna
Obiliq

Bazuar ne nenin 28 dhe 58 shkronja "a" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008), nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Ndërkomunal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/10 Gusht 2011, nenin 43 par. 1 dhe 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenin 52 shkronja "a" të Statutit të Komunës së Prishtinës, nenin 77 par. 1 nënparagrafi 1.1 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, nenin 72 par. 1 nënparagrafi 1.1 të Statutit të Komunës së Obiliqit, nenin 61 par. 1 nënparagrafi 1.1 të Statutit të Komunës së Podujevës, lidhet kjo:

**MARRËVESHJE MIRËKUPITIMI
PËR FINANCIM TË PËRBASHKËT**

Palët nënshkruese:

1. Kryeqyteti i Prishtinës, përfaqësuar nga Kryetari i Kryeqytetit, z. Përparim Rama
2. Komuna e Mitrovicës së Jugut, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Bedri Hamza
3. Komuna e Vushtrrisë, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Ferit Idrizi
4. Komuna e Podujevës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Shpejtim Bulliqi
5. Komuna e Obiliqit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Xhafer Gashi

**Neni 1
Lëndë e marrëveshjes**

Lëndë e kësaj marrëveshje është hartimi i Projektit ideor dhe detaj/zbatues si dhe Studimi i Fizibilitetit për ndërtimin e rrugës: Barilevë-Kozaricë-Dunnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë" në gjatësi afërsisht 30 km. dhe gjerësi (e asfaltit) b=7m.

Neni 2 Qëllimi i marrëveshjes

1. Kryeqyteti i Prishtinës, Komunat; Mitrovicë e Jugut, Vushtrri, Obiliq dhe Podujevë, me nënshkrimin e kësaj marrëveshje kanë për qëllim financimin e të studimit të fizibilitetit dhe hartimin e projektit ideor dhe detaj/zbatues në bazë të të cilit do të ndërtohet rruga e cekur si në nenin 1 të kësaj marrëveshje.
2. Bashkëpunimi i Kryeqytetit të Prishtinës dhe komunave: Mitrovicë e Jugut, Vushtrri, Obiliq dhe Podujevë sipas kësaj marrëveshje do të realizohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të ndërsjellë.
3. Ky projekt vlerësohet të jetë i një rëndësie tejte të veçantë për banorët e zonave urbane të komunave të sipërcëkura duke ditur se pozita gjeografike e regjionit të Shalës është e përshtatshme për turizëm malorë ku përveç ajrit të pastër dhe ujit të kualitetit të lartë, ky vend konsiderohet se është ndër vendet më atraktive në Kosovë. Konfiguracioni i terrenit është i përshtatshëm për ndërtim të kësaj rruge edhe pse është teren kodrinor malor por që ka një pjerhtësi shumë të vogël.

Neni 3 Financimi

1. Vlera e përafërt paralogaritare për studimin e fizibilitetit është 14,000.00 € (katërmëdhjetë mijë euro) ndërsa për projektin ideor dhe detaj/zbatues është 17,000.00 € (shtatëmbëdhjetë mijë euro).
2. Palët nënshkruese pajtohen që të participojnë me mjete financiare nga buxhetet e tyre, secila nga 20 % të vlerës paralogaritare të precizuar në paragrafin paraprak të këtij neni.

Neni 4 Obligimet e palëve të marrëveshjes

1. Palët pajtohen që procedurat e prokurimit t'i zhvilloj Komuna e Vushtrrisë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
2. Secila nga palët nënshkruese të kësaj marrëveshje do të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve dhe dorëzoj në Komunën e Vushtrrisë – Drejtorinë e Prokurimit Publik.
3. Dokumentet: Studimi i fizibilitetit dhe Projekti ideor dhe detaj/zbatues, pas përfundimit të procedurave të pranimit nga komisioni për pranim, do të arkivohen në Drejtorinë për Prokurim Publik në Vushtrri. Këto dokumente do të iu ipen investitorit/rëve të ardhshëm që do të investoj/në në implementimin e projektit për ndërtimin e rrugës Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë”.
4. Mjetet financiare eventualisht të mbetura nga ky projekt sipas kësaj marrëveshje do kthehen në shumta të njëjta në buxhetet e secilës komunë e cila ka participuar.
5. Në fazat e zbatimit të procedurave të prokurimit, secila palë do të emëroj nga një anëtarë në komisionin për vlerësim të ofertave si dhe komisionin për pranim teknik, emrat e të cilëve duhet dërguar në Drejtorinë për prokurim publik në Vushtrri.

Neni 5
Kohëzgjatja

Palët pajtohen që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të realizohet brenda viti 2024. Në rast të pengesave të arsyeshme objektive, obligimet e palëve nënshkruese barten në vitin 2025.

Neni 6
Koordinatorët

Palët pajtohen që secila t'a caktoj nga një zyrtar në cilësi të koordinatorit për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshje.

Koordinatorët:

Kryeqyteti i Prishtinës,
Emri:
Tel.
E-mail

Komuna e Mitrovicës së Jugut,
Emri:
Tel.
E-mail:

Komuna e Vushtrisë,
Emri:
Tel.
E-mail

Komuna e Obiliqit,
Emri:
Tel.
E-mail

Komuna e Podujevës,
Emri:
Tel.
E-mail

Neni 7
Dakordimet në mes të palëve

Palët bien dakord që obligimet që merren përsipër në këtë marrëveshje të realizohen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Neni 8
Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të secilës nga palët nënshkruese, kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet me aneks marrëveshje.

2. Palët mbajjnë të drejtën e ndërprerjes së kësaj marrëveshje në rast se pala tjetër nuk i përmbushë obligimet nga kjo marrëveshje.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën çështja do të kalohet në Gjykatën kompetente.

Neni 10
Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje të hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshënisë nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe miratimit në kuvendet e komunave të specifikuar në këtë Marrëveshje.
2. Marrëveshja e mirëkuptimit është hartuar në 5 kopje në origjinal, nga një për secilën palë nënshkruese.

Datë, _____ 2024

KRYEQYTETI
PRISHTINË

KOMUNA
MITROVICË E JUGUT

KOMUNA
VUSHTRRI

KOMUNA
OBILIQ

KOMUNA
PODUJEVË

z. Përparim Rama
Kryetar

z. Bedri Hamza
Kryetar

z. Ferit Idrizi
Kryetar

z. Xhafer Gashi
Kryetar

z. Shpejtim Bulliqi
Kryetar